

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr 5003 Rep.

Nr \_\_\_\_\_ Kol.

896



**KONTRATË SHITJE KUOTASH**

Në Tiranë, Shqipëri, sot më datë 11/06/2019(dy mijë e nëntëmbëdhjetë), në praninë time Majlinda Demollari , Notere e Dhomës së Noterisë Tiranë , me seli në Rruga "Vaso Pasha" Tiranë, u paraqitën palët si më poshtë:

**1. Shitesi: Priam Ramaj** lindur më 28.04.1985,banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal I50428085I, në cilësinë e ortakut 25% të kapitalit të shoqërisë "CHEFEE" shpk, me NIPT **L82103005M**, me seli ne Rr. Brigada VIII, Tiranë.

**2. Blerësi: Ali Katorri** lindur më 17.10.1961,banues në Tiranë,shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër Nr. Personal G11017033B.

*(Blerësi dhe Shitësi do ti referohemi në këtë kontratë së bashku palët dhe vec e vec pala).*

Unë, Noteri, pas verifikimit të dokumentave të depozituara direkt nga palët ose nga përfaqësuesit e tyre, vërtetoj se palët kanë zotësi juridike dhe për të vepruar. Bazuar në vullnetin e tyre të lirë, palët kërkuan dhe janë dakord që të hartoj këtë kontratë shitje kuotash bazuar në Ligjet e Republikës së Shqipërisë me këto terma dhe kushte si më poshtë:

**DUKE QENË SE:**

Shitësi Priam Ramaj në cilësinë e ortakut të shoqërisë "CHEFEE" shpk, me NIPT **L82103005M** është ortakut i vetëm i 25 kuotave që përbëjnë 25% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 250,00 (dyqind e pesëdhjetë) lekë.

Sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi i blen shitësit, Kuotat në Shitje, në datën e Nënshkrimit, të lira nga cdo Barrë.

Blerësi fiton pronësinë mbi Kuotat , dhe të gjitha të drejtat e lidhura me pronësinë , sipas kufizimeve të Nenit 7, mbi kuotat në Shitje, në Datën e Nënshkrimit. Blerësit i lind e drejta në Datën e Nënshkrimit të regjistrojë pronësinë e tij mbi Kuotat në Shitje në QKR, në librat e Shoqërisë dhe në cdo organ tjetër kompetent.

**DUKE QENË SE:**

A blue ink signature, likely of the seller Priam Ramaj, written over the text 'DUKE QENË SE:'.

A blue ink signature, likely of the buyer Ali Katorri, written on the right side of the page.

Blerësi dhe Shitësi kanë rënë dakort që me plotësimin e disa kushteve të caktuara, Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit, i cili dëshiron të blejë prej shitësit 25% të Kuotave të Shoqërisë "CHEFEE" shpk.

## **DUKE QENË SE:**

Ky transferim është autorizuar nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "CHEFEE" shpk me Vendimin Nr. 1 datë 05/06/2019.

## **PRANDAJ**

Në vijim të sa më sipër, dhe në vendimin e përmendur këtu, palët në këtë mënyrë kanë rënë dakort si më poshtë vijon:

### **1. Përshkrime, përkufizime, Interpretime :**

- 1.1 Të gjitha përshkrimet e mësipërme të këtij dokumenti përfaqësojnë një pjesë integrale të kësaj kontrate.
- 1.2 Gjinia dhe numri.Ndonjë referencë në këtë kontratë në gjini do të përfshijë të gjitha gjinitë, dhe fjalët në numrin njëjës do të përfshijnë dhe ato në shumës dhe e kundërta, përveçse nëse specifikohet ndryshe.
- 1.3 Titujt, etj.Ndarja e kësaj kontrate në Nenet, paragrafet, klauzolat dhe nëndarjet e tjera si dhe edhe futja e kreut janë vetëm për përshtatjen e përshkrimeve dhe nuk do të ndikojë ose të përdoret në ndërtimin apo interpretimin e kësaj kontrate.
- 1.4 Monedha. Të gjitha referimet në këtë Kontratë me monedhë, përveçse kur është parashikuar ndryshe, do të jetë Leku Shqiptar.

### **2. Qëllimi i Kontratës.**

- 2.1 Subjektet e termave dhe kushteve të kësaj kontrate, Shitësi është dakord të shesi, transferojë dhe dorëzojë tek Blerësi dhe Blerësi është dakord të blejë dhe pranojë dorëzimin e kuotave të Shoqërisë "CHEFEE" shpk.
- 2.2 Blerësi do ti paguajë shitësit shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) lekë, i njohur si cmim i shitjes.  
*Cmimi i shitjes së kuotave do i likujdohet palës shitëse jashtë kësaj zyre noteriale.*
- 2.3 Shoqëria "CHEFEE" shpk do të marrë të gjitha veprimet për të regjistruar kontratën e shitjes së kuotave sic kërkohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, për depozitimin e kësaj kontrate në regjistrin tregtar Shqiptar.

### **3. Përfaqësimet dhe Garancitë.**

Shitësi përfaqëson dhe garanton si më poshtë:

Ekzekutimi i caktuar.

Kjo Kontratë është ekzekutuar nga Shitësi dhe kjo kontratë konstituon në detyrime të vlefshme dhe ligjërish të detyrueshme për Shitësin, të zbatueshme në përputhje me termat e saj.

Pa konflikt. Hartimi i kësaj kontrate dhe përputhshmëria me termat këtu, nuk do të jetë në konflikt me/ose rezultojë në shkelje me ndonjë dispozitë apo të kërkojë ndonjë pëlqim ose të rezultojë në imponim të ndonjë pengu, të ndonjë marrëveshje ose instrumenti në të cilin Shitësi është palë ose Shitësi ose ndonjë nga asetet janë të detyruar; dhe nuk do të paguajë ose një fakt i cili më dhënien e njoftimit, kalimi i kohës ose kryerja e ndonjë përcaktimi ose ndonjë kombinimi këtu, do të përbëjë mospërbushje të detyrimeve të kësaj kontrate.

#### 4. Të Ndryshme

Cdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër që duhet dhënë ose bërë sipas kësaj kontrate drejt Blerësit ose Shitësit do të bëhet me shkrim përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë. Njoftimi, kërkesa ose komunikim tjetër do të konsiderohet që i është dhënë ose bërë kur ai do i dorëzohet dorazi, me postë palës të së cilës i kërkohet ose lejohet ti jepet ose bërë në adresën e palëes ose adresë tjetër që pala ka caktuar, duke e njoftuar palën tjetër për të dhënë apo bërë njoftime të tilla, aplikime ose komunikime të tjera.

#### LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Kjo Kontratë do të hartohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjin Shqiptar. Cdo mosmarrëveshje, polemikë ose pretendim që ka ardhur si rezultat i zbatimit të kësaj kontrate ose prishje, mbarim, ose pavlefshmëri prej kësaj, do të zgjidhet nga gjykata kompetente Shqiptare.

Gjuha. Kjo Kontratë u hartua në gjuhën shqipe në 4(katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Unë, Notere Publike, pasi lexova Palëve me zë të lartë përmbajtjen e plotë të kësaj kontrate, e gjej kontratën në përputhje me vullnetin tyre të plotë e të lirë, dhe pasi Palët nënshkruan në praninë time, vërtetoj firmat sipas ligjit shqiptar.

Palët këtu, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre kanë nënshkruar këtë kontratë sipas emrave respective në ditën e nënshkrimit.

Shitësi

PRIAM RAMAJ

*Priam Ramaj*

Blerësi

ALI KATORRI

*Ali Katorri*

NOTERE

NOTERE  
Majlinda E. Demollari  
NRT: K91606040A  
Tel: 0682061560